



HEQJE DORË NGA PËRGJEGJËSIA: Jeni të lutur të vini re se publikimi i tekstit ligjor të mëposhtëm nuk është zyrtar dhe NUK përbën dokument zyrtar të Republikës së Shqipërisë. Konsiderohet thjesht si mjet dokumentimi dhe EURALIUS-i nuk merr asnjë përgjegjësi për përmbajtjen.

LIGJ

Nr.9787, datë 19.7.2007

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7638, DATË 19.11.1992 "PËR SHOQËRITË TREGTARE", TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në fund të nenit 47 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", të ndryshuar, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Përjashtimisht këtij rregulli, në shoqëritë me kapital të përbashkët, për kapitalin shtetëror, që i përgjigjet pasurive të paluajtshme të shoqërisë, që i janë njohur ose kthyer ish-pronarëve, sipas legjislacionit në fuqi, ortaku shtetëror zëvendësohet nga ish-pronari në të drejtat e tij mbi pjesën takuese të këtij kapitali. Transferimi i pjesëve të kapitalit në favor të ish-pronarit, i cili zëvendëson shtetin në të drejtat e tij mbi këtë pjesë kapitali, bëhet me akt noterial, sipas procedurave të parashikuara në ligj."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5442, datë 31.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi.